

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 07-13.10.2024

Janë testuar gjithsej 198 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=255) është shënuar një rënie prej 22,4%.

Pozitive janë 12 raste, me një rënie të numrit nga java e kaluar për 40,0%. Përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 13,2%, mesatarisht 4,3%.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 07-13.10.2024

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
07.10.2024	38	5	13,2%
08.10.2024	44	4	9,1%
09.10.2024	56	1	1,8%
10.10.2024	32	2	6,3%
11.10.2024	8	0	0,0%
12.10.2024	14	0	0,0%
13.10.2024	6	0	0,0%
Gjithsej	198	12	mesatarja 4,3%

Gjatë javës së kaluar raste janë regjistruar në 3 qytete. Numri më i madh është regjistruar në Shkup (n=10; 83,3%), ndërsa incidencë më e lartë në Ohër (1,8/100.000). (Tabela 2).

Raste të reja janë regjistruar tek grupmoshat mbi 30 vjet, ndërsa numri më i madh i përket grupmoshës mbi 60 vjet (n=8; 40,0%).

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 24 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (30.09-06.10.2024), është raportuar një rast i vdekjes si pasojë e COVID-19, nga Shkupi, në moshë mbi 60 vjet, i pa vaksinuar dhe pa komorbiditete, e që ka ndërruar jetë në spital.

GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2024, deri më 13.10.2024, janë regjistruar gjithsej 1.701 raste me COVID-19. Në muajin shtator të vitit 2024 (288) regjistrohet një rënie prej 65,3% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 13.10.2024, janë testuar gjithsej 11.543 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Rritja e aktivitetit SARS-CoV-2 e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 14.10.2024

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>